



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:197754

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734629

KE.nr.1183/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit “Koninklije PHILIPS N.V.” me seli në High Tech Campus 5, 5656 AE, Eindhoven, Holandë, me numër regjistrimi 17001910, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit “MILI COMPANY” SH.P.K., me NUI: 810864737, me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 14.05.2024, në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Koninklije PHILIPS N.V.” dhe Vërtetohet se i padituri “MILI COMPANY” SH.P.K., me importimin e 450 drita LED, ka shkelur markën tregtare të paditësit “PHILIPS”.
- II. I NDALOHET të paditurit “MILI COMPANY” SH.P.K., që të importoj mallrat që shkelin markën tregtare të paditësit “PHILIPS”.
- III. LEJOHET shkatërrimi i mallrave 450 drita LED, që shkelin markën tregtare të paditësit dhe OBIGOHET i padituri që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- IV. OBLIGOHET i padituri që të paguaj shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimit të mallrave 450 drita LED, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

- V. OBLIGOHET i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,610.00 € (një mijë e gjashtëqind e dhjetë euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi “Koninklije PHILIPS N.V.”, përmes të autorizuarit të tij, me datë 06.09.2021, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare kundër të paditurit “MILI COMPANY” SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri “MILI COMPANY” SH.P.K., ka shkelur markën tregtare të paditësit “Philips” me numër regjistrimi 019056, të i ndalohet të paditurit që në të ardhmen të importoj mallrat që shkelin markën tregtare të paditësit, të lejohet shkatërrimi i mallrave 450 drita LED, që shkelin markën tregtare të paditësit dhe të obligohet i padituri që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, të obligohet i padituri që të paguaj shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimit të mallrave 450 drita LED, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, të obligohet i padituri që paditësit t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar për shkak të dëmtimit të imazhit të markës tregtare, si dhe të obligohet i padituri që të paguaj shpenzimet e procedurës konstestimore. Në seancën e datës 15.02.2023, është tërhequr nga pika V e kërkesëpadisë, përkatësisht nga kërkesa për kompensimin e dëmit të shkaktuar për shkak të dëmtimit të imazhit të markës tregtare.

I autorizuari i paditësit në padi, gjatë seancës gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se pretendimi i të paditurit se mallrat janë origjinale dhe janë të prodhuara nga vet paditësi, nuk është i sajte sepse paditësi para se të ushtronte këtë padi, e ka verifikuar mallin dhe ka konstatuar se të njëjtat janë të falsifikuara dhe duke marrë parasysh se në mallin e importuar kontestues është përdorur marka tregtare e mbrojtur në formën identike, në bazë të nenit 8 të Ligjit për Markat Tregtare i takon të paditurit të vërtetoj se malli është origjinal. Tuje ka shtuar se sipas opinionit dhe deklaratës nën betim është theksuar se produktet janë të falsifikuara, logoja është paraqitur në mënyrë të gabuar dhe pas krahasimit të dy logove është konfirmuar se produktet e sekuestruara nuk janë prodhuar apo aprovuar nga Philips dhe si rrjedhojë të njëjtat konsiderohet si produkte të falsifikuara. Sa i përket pretendimeve se poqët elektrik nuk kanë asnjë shenjë me përmbajtje të emrit Philips, ka

deklaruar se nuk është kontestuese se poqët kanë qenë të vendosur në paketimet e tyre dhe nuk kanë ardhur të ndarë, prandaj një produkt i tillë konsiderohet si një i vetëm dhe asesi nuk është e mundur që të ndahet në kuptim ligjor dhe të asgjësohet paketimi dhe të vihet në qarkullim të lirë poqi duke u larguar nga paketimi. Ka shtuar se nga provat e administruara në këtë procedurë është vërtetuar se i padituri përmes importimit të 450 dritave LED ka shkelur markën e mbrojtur të paditësit dhe nga krahasimi i mostrave të mallrave të paditësit me mallrat e importuara nga i padituri, vërtetohet fakti se në mallrat e importuara nga i padituri është përdorur shenja e mbrojtur e paditësit dhe në këtë mënyrë vërtetohet fakti se mallrat e të paditurit përbëjnë shkelje të markës tregtare të paditësit. Tutje ka shtuar se mallrat e importuara nga i padituri nuk janë prodhuar as me leje e as me licencë nga paditësi dhe si të tillë janë mallra të falsifikuar të cilët e imitojnë markën e mbrojtur të paditësit, fakt i cili është konfirmuar përmes deklaratës nën betim të paditësit ku është theksuar se në mallrat e të paditurit është përdorur një logo e falsifikuar e cila është jashtë përdorimit që nga viti 2013. Ka shtuar se nga krahasimi i mostrave të produkteve vërtetohet se në rastin konkret ka shkelje tipike të markës së mbrojtur, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurit në përgjigje në padi, gjatë seancës gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke shtuar se nuk është e qartë se çfarë lloj verifikimi i mallit është bërë dhe se ku apo cilat janë ato elemente që e kanë bërë paditësin të konstatoj se malli i importuar dhe i ndaluar në doganë është mall jo origjinal. Ka shtuar se mallrat e importuara janë origjinal dhe nuk përbëjnë shkelje të markës tregtare andaj padia e paditësit është e pabazuar dhe e pambështetur në prova dhe në fakte të cilat do të vërtetonin se malli kontestues është mall i cili shkel markën tregtare të mbrojtur në territorin e Kosovës. Tutje ka shtuar se në padi gjenden vetëm fotografitë e paketimeve të produkteve që në këtë rast janë poqa elektrik, por nuk gjendet malli që janë poqët elektrik e të cilët sipas informacionit të marr nga klienti nuk kanë asnjë shenjë me përmbajtje të emrit Philips. Sipas nenit 5 të Ligjit për Markat Tregtare definohet se çka përbën markë tregtare dhe bën diferencimin mes mallrave dhe paketimeve të mallrave, duke numëruar se markë tregtare mund të jenë format e mallrave ose paketimet e tyre, rrjedhimisht pa pasur një mostër të produkteve që të ekzaminohet nga gjykata fizikisht, do të jetë e pamundur të konstatohet se markën tregtare të paditësit e shkelin paketimet e këtyre mallrave apo vet malli, respektivisht poqët elektrik, ndërsa nga Dogana e Kosovës lejohet zhdoganimi - vendosja në qarkullim të lirë e mallrave edhe pa paketim, që

nënkupton se është e rëndësishme të konstatohet nëse mallra kanë ndonjë shenjë që përmban markën e paditësit. Sa i përket parashtrësës së lëshuar nga Jan Devissel, ka deklaruar se e njëjta nuk mund të merret si provë e besueshme sepse është lëshuar nga një punonjës i paditësit dhe rrjedhimisht nuk ka fuqi provuese, e për më tepër në këtë parashtrësë i njëjti ka deklaruar se mendimin e tij e mbështet në fotografi edhe jo në ekzaminim të drejtpërdrejtë të mallrave të ndaluara dhe i njëjti është lëshuar vetëm për paketimet e mallrave dhe jo për mallin – poqët elektrik, ndërsa objekti i kërkesës së paditësit është shkatërrimi i mallit në tërësi. Tutje ka shtuar se për mallrat të cilat nuk janë për konsum nuk kërkohet detyrimisht nga Dogana e Kosovës që mallrat të jenë vendosura në paketime për secilin produkt veç e veç, ndërsa tek mallrat ushqimor para importit bëhen edhe analizat e produktit nga institucionet tjera kompetente dhe është kusht ligjor që ato të importohen në kushtet fizike të caktuara e që nënkupton të jenë të paketuara. Ka shtuar se nga krahasimi i mostrave të siguruar nga Dogana e Kosovës për mallrat e ndaluara të të paditurit dhe mallrave të paditësit vërehet se të njëjtat janë identike dhe nuk janë mallra të falsifikuara, të cilat kanë edhe logo identike. Ka shtuar se meqenëse mallrat e të paditurit janë origjinale, nënkupton se nuk ka shkelje të markës tregtare, andaj gjykatës i ka propozuar që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor publik të datës 14.05.2024, bëri administrimin e të gjitha provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe atë: Ekstrakti nga Regjistri Online i Markave Tregtare me numër të regjistrimit 019056 i datës 14.10.2016 dhe me numër aplikimi KS/M/2014/000831 i datës 29.08.2014; Ekstrakti nga Regjistri Online i Markave Tregtare me numër të regjistrimit 023892 i datës 27.11.2018 dhe me numër aplikimi KS/M/2017/001260 i datës 16.10.2017; Njoftimi nga Dogana e Kosovës rasti me numër 254 -2021 Philips i datës 23.08.2021; Opinioni i ekspertit – deklaratë nwn betim e datës 22.03.2023 me numër të referencës 2016 PJT 00481; Mostrat e dorëzuara nga paditësi gjithsej 4 poçe; Mostrat e të paditurit të dorëzuara nga Dogana gjithsej 2 poçe.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar për shkaqet si në vijim:

Nga Ekstrakti nga Regjistri Online i Markave Tregtare me numër të regjistrimit 019056 i datës 14.10.2016 dhe me numër aplikimi KS/M/2014/000831 i datës 29.08.2014 dhe Ekstrakti nga Regjistri Online i Markave Tregtare me numër të regjistrimit 023892 i datës 27.11.2018 dhe me numër aplikimi KS/M/2017/001260 i datës 16.10.2017, vërtetohet se paditësi ka të regjistruar pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare figurative dhe markës tregtare verbale PHILIPS për produktet dhe shërbimet nga Klasa 7, 8, 9, 10, 11, 14, 16, 21, 28, 35, 37, 38, 41, 42, 44, dhe 45 të Klasifikimit të Nices.

Nga Njoftimi nga Dogana e Kosovës rasti me numër 254 -2021 Philips i datës 23.08.2021, vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të drejtës së markave tregtare të paditësit.

Nga mostrat e dorëzuara nga paditësi gjithsej 4 poçe dhe mostrat e të paditurit të dorëzuara nga Dogana gjithsej 2 poçe, vërtetohet se mallrat kontestuese të të paditurit përmbajnë shenjën identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse fjala dhe shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT - i aplikueshëm në rastin konkret), të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullari i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka të drejtë që: të ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion

(Nenet 8 – 13 i LMT); të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe të disponojë me markën tregtare të tij (Nenet 15 – 22 të LMT-së).

Mbajtësi i një marke tregtare sipas nenit 8 të LMT-së, ka të drejtë të ndalojë: vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare; përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj sipas nenit 8 të LMT-së, përbën shkelje të markës tregtare. Shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëri prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se i padituri ka importuar mallrat kontestuese pa autorizimin e paditësit si bartës i të drejtave nga marka tregtare e regjistruar “PHILIPS”. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fakti se mallrat janë origjinale ose jo, nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare. Bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të markës tregtare.

Gjykata vlerësoi edhe Opinionin e ekspertit – deklaratë nën betim e datës 22.03.2023 me numër të referencës 2016 PJT 00481, mirëpo gjeti se i njëjti nuk kishte ndikim për vendosjen ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Prandaj duke u nisur nga të sipër cekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata ka konstatuar se i padituri përmes vënies në qarkullim të produkteve me emrin “PHILIPS”, ka shkelur markën tregtare të paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së

precizuar si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi me zbatimin e rritjes prej 100% për shkak të kontestit me element të huaj sipas tarifës së OAK dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 208.00 €, për taksën gjyqësore shumë prej 50.00 € si dhe përfaqësim në pesë seanca gjyqësore shumë prej 1,352.00 € (5x270.40), në shumë të përgjithshme prej 1,610.00 €.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1183/22, datë 24.05.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.